



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2025

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Drejtuar: OE PEPA GROUP GROUP shpk me NIPT L42215009L, me adrese Tirane KASHAR
Autostrada Tirane Durres km 6, Zona Kadastrale nr.2105, Nr Pasurie 1168/13

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-49209-05-27-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “RIKONSTRUKSION I MATERNITETIT FIER PËR SPITALIN FIER”, me afat **13 muaj sipas grafikut të punimeve.**

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit:04.07.2025.

Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Nr.34 Datë.07.07.2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☒
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE “Ante-Group ” shpk

J62904100D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera: 142,435,614.7 (njëqind e dyzet e dy milion e katërqind tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e katërmëdhjetë pikë shtatë) lekë pa tvsh.OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “AVDULI” shpk

J66703306O

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 135,784,120 (Njëqind e tridhjetë e pesë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e njetë) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “BE - IS” shpk

K71412003A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 169.577.605 (njëqind gjashtëdhjetë e nentë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e pesë) lekë pa tvsh totali i pikëve të marra **258,30**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “DESARET COMPANY” shpk

K01816001J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 156,178,872.04 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtëmilion e njëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy pikë zero katër) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. “ERGI” shpk

K02727229P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 134,311,259.1 (njëqind tridhjetë e katër milion e treqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nentë pikë një) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. “INA” shpk

J61814009W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 150,267,304 (Njëqind e pesëdhjetë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e treqind e katër) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. “INERTI” shpk

J66926804L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 130,965,045.51 (njëqind e tridhjet milion e nentëqind e gjashtëdhjet e pese mijë e dyzet e pese pike pesëdhjet e nje) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

8. “K A C D E D J A” shpk

K51712017A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 169,682,281.52 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e tetëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e dy) lekë pa tvsh. Totali i pikëve te marra **252,90**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

9. BOE “KEVIN KONSTRUKSION” shpk

K71401004W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

&

“ALB TIEFBAU” shpk

J66703049C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 153,698,258.64 (njëqind e pesëdhjetë e tre milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

10. “LEON KONSTRUKSION” shpk

K71820009I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 151,835,728.33 (njëqind e pesëdhjetë e një milion e tetëqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e tetë pikë tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

11. **BOE “MF INVEST GROUP” shpk**

L71830010R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

&

“ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk

K91628013D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

&

“ALKO–IMPEX General Construction” shpk

K91326028I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **144,043,342.53 lekë** (njëqind e dyzet e katër milion e dyzet e tre mijë e treqind e dyzet e dy pikë pesëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

12. **BOE “MODESTE” shpk**

J62903413B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

&

“DION-AL ” shpk

K67917301H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **146,226,289.77 lekë** (njëqind e dyzet e gjashtë milion e dyqind e njëzet e gjashtë mijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

13. **“PEPA GROUP GROUP” shpk**

L42215009L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera **148,163,191.77 lekë** (njëqind e dyzet e tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një pikë shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh. totali i pikëve të marra **292,35**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

14. “PE - VLA - KU” shpk

K61716013M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 147,797,924.32 lekë (njëqind e dyzet e shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e njëzet e katër pikë tridhjetë e dy) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

15. “S P E K T R I” shpk

J62903555F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 0 lekë (zero) lekë pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “Ante-Group ” shpk

J62904100D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 1, shkronjën b. “Sigurimin e Ofertës”, sipas Shtojcës 3 pasi nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertës per proceduren objekt prokurimi. Ofertuesi ka paraqitur “Sigurim oferte” të një procedure te ndryshme nga ajo e publikuar nga Autoriteti Kontraktor dhe konkretisht per proceduren me object: “Riforcim godine banimi 10-11 kate mbi tokë dhe një kat nëntokë” me vlerë 1,791,488 lekë, i publikuar nga Bashkia Durrës.
- Operatori ekonomik “Ante-Group” shpk dhe subjekti mbështetës “Nova Konstruktion Group” sh.p.k, nuk plotësojnë pikën 1, shkronjën “a” të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit pasi nuk kanë paraqitur “Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit” sipas shtojcës 8, të miratuar me Vendimin nr. 10, date 23.09.2024 “Per miratimin e dokumentave standarde te tenderit per mallra, pune, sherbime per proceduren e prokurimit “E hapur-Punë”. Në rastin konkret operatorët ekonomik kanë përdorur një tjetër formular vetëdeklarimi nga ai i publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit ku mungojnë krejtësisht deklaratimet e detyrueshme:
 - *Vetdeklarimi se Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.*
 - *Vetdeklarimi se Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.*

2. “AVDULI” shpk

J66703306O

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Për arsyet e mëposhtme:

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.2.2, në të cilën është kërkuar: ... “Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës.(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor)”.

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “AVDULI” shpk ka paraqitur vertetim për xhiron e tre viteve të fundit me Nr. T13322138, date 30.05.2025, ku rezulton se xhiro per vitin 2022 është në vlerën: 178,174,370 lekë, për vitin 2023 është në vlerën 122,984,236 ndersa per vitin 2024 në vlerën 181,918,458 lekë.

Sa me lartë ofertuesi nuk permbush kriterin për të paktën 1 (një) vit, xhiro vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të kontratës në shumën: 187,488,213.26 lekë pa TVSH.

në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitura për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:

Nr.	Periodha Tatimore	Shuma
1	24-A	178,174,370
2	23-A	122,984,236
3	22-A	181,918,458

3. “DESARET COMPANY” shpk

K01816001J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Për arsyet e mëposhtme:

➤ Operatori ekonomik me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.6 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponimin e stafit teknik për kryerjen e punimeve, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certificate /diplomë) nga organe kompetente si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
<i>Teknik Ndërtimi</i>	<i>1</i>
<i>Teknik IT/Elektronik</i>	<i>1</i>
<i>Hidraulik</i>	<i>2</i>
<i>Elektricitist</i>	<i>3</i>
<i>Instalues dhe riparues të sistemeve ngrohje-ftohje</i>	<i>2</i>
<i>Punonjes i izolimeve (Hidroizolues)</i>	<i>2</i>
<i>Betonues</i>	<i>2</i>
<i>Karpentier</i>	<i>2</i>
<i>Hekurkthyes</i>	<i>1</i>
<i>Murator</i>	<i>1</i>
<i>Suvatues</i>	<i>3</i>
<i>Pllakashtrues</i>	<i>2</i>
<i>Specialist gipsi</i>	<i>2</i>
<i>Punonjes për dritare</i>	<i>2</i>
<i>Bojaxhi</i>	<i>2</i>
<i>Shofer</i>	<i>3</i>
<i>Automakinist</i>	<i>1</i>
<i>Eskavatorist</i>	<i>2</i>

Nga verifikimi i Formularit Permbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur ofertuesi Seksioni B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” rezulton se ofertuesit nuk ka deklaruar se disponon 2 (dy) punonjës me profesion “Karpentier”.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër dhe referuar volumeve të punimeve të ndërtimit, KVO gjykon se ofertuesi nuk disponon personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

4. “INA” shpk

J61814009W

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Për arsyet e mëposhtme:

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur në SPE, ofertuesi ka deklaruar se drejtuesi teknik i punimeve do të jetë Z. Alfred Depa, i cili nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punime në objekt. Nga verifikimi i Formularit Permbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik të paraqitur në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtimi i shtesës në objektin arsimor, Shkolla e Mesme Profesionale “Hamdi Bushati” Shkodër” me nr. REF-33133-12-12-2024, ku ky operator është shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktor “Operatori I Blerjeve të Perqendruara, rezulton se ofertuesi ka caktuar të njëjtin drejtues teknik të punimeve.

Bazuar në dispozitat e nenin 2, Kreu I të Udhëzimit nr.2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” në të cilët ndër të tjera parashikohet se: *Neni 2: “2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipermarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milion) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”* operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të “Kapacitetit teknik” pasi drejtuesi teknik i punimeve është i angazhur në kontrata të tjera.

5. BOE “MF INVEST GROUP” shpk

L71830010R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

&

“ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk

K91628013D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

&

“ALKO-IMPEX General Construction” shpk

K91326028I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Për arsyet e mëposhtme:

➤ Operatori ekonomik “MF INVEST GROUP” shpk nuk plotëson pikën 2.2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” në të cilën është kërkuar: “*Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor)*”.

Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “MF INVEST GROUP” shpk nuk ka paraqitur “vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

➤ B.O.E “MF INVEST GROUP” shpk & “ALKO IMPEX CONSTRUCTION” shpk & “ALKO – IMPEX General Construction” Dh.sh.h me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.7 të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin e stafit mbështetës (me kontratë pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- 1 (një) punonjës me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4.

- 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikatë : “Specialist për punimet në lartësi”.sipas V.K.M Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, të cilat të jenë të lëshuara nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- 1 (një) punonjës i pajisur me Certifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në lidhje me këtë punonjëse të paraqitet edhe certifikimi përkatës për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).

- Diplomë/Certifikatë

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do

të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Nga verifikimi i Formularëve Permbledhës të Vetëdeklarimit të paraqitur bashkimi i operatoreve ekonomik, Seksioni B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” rezulton se ofertuesit nuk kanë deklaruar se disponojnë 2 (dy) punonjës të pajisur me certifikatë: “*Specialist për punimet në lartësi*”. Nga dokumentacioni i paraqitur në SPE rezulton se ofertuesit kanë deklaruar 1 (një) punonjës (*punonjesin: E.A*) me profilin “*Specialist për punimet në lartësi*” nga 2 (dy) të kërkuar ne DST.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër dhe referuar volumeve të punimeve të ndërtimit, KVO gjykon se ofertuesi nuk disponon personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.8/b, të “Kapacitetit Teknik” të kriterëve të vecanta ku është kërkuar: “Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha paisjet sipas pikës 2.3.8. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Nga verifikimi i katalogut të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik për pajisen: “Central Zjarri i Adresueshem i kompozuar, i kompletuar me dy Loop, i certifikuar EN 54-2, EN 54-4. Mundësi zgjerimi deri në 8 loop. Mundësi për të ndarë në 2000 zona. Të ruaj deri në 10000 ngjarje. Set kablllo modul kontrolli-bateri. Set kablllo modul kontrolli-UPS. Kavallotë lidhje skedash 2 vende” konstatohet mospërputhje midis specifikimet teknike të kërkuar nga DST dhe atyre të ofruara nga ofertuesi.

Konkretisht, ofertuesi ka dorëzuar në SPE të dhënat mbi modelin dhe kompaninë prodhuese për pajisjen “Central Zjarri” model “AVENAR Panel 2000” të prodhuar nga shoqëria “BOSCH”. Nga verifikimi i katalogut të pajisjes rezulton se specifikimet teknike të tij nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST pasi pajisja e ofertuar nga operatori ekonomik është e kompozuar në 4 Loop (maksimumi) dhe nuk ka mundësi zgjerimi deri në 8 loop.

6. “S P E K T R I” shpk

J62903555F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor dhe teknik për të provuar që përmbush kërkesat e veçanta për kualifikim të përcaktuara në DST.

7. BOE “MODESTE” shpk

J62903413B

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

&

“DION-AL” shpk

K67917301H

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Për arsyet e mëposhtme:

Bashkimi I Operatoreve Ekonomik, me dokumentacionin ligjor të paraqitur nuk plotëson pikën 2.3.8/b të “Kapacitetit teknik” të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponimin e stafit mbështetës (me kontratë pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

“Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha pajisjet/materialet sipas pikës 2.3.8. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE nga BOE rezulton se për përmbushjen e kriterit është ngarkuar dokumentacioni si më poshtë:

EMERTIMI I PAISJES	MODEL	KOMPANIA PRODHUESE	DISTRIBUTOR
<i>F. NJESI TRAJTIMI AJRI - (me bateri me AHU KIT) V.ajri max. 4000m³/h ~ Renia e presionit të jashtëm dergim/kthim 600/250 Pa Fel.e vetilator. 2x0.75 kW 1F~230V,50Hz Kap.termik në ngrohje/ftohje:40.0 kW/ 65 kË Bateria pas ngrohjeje elek.me fuqi 20 kW.F. elektrike e vent/drg 11kW 3F+N/400V/50Hz/kthim 4kW</i>	Model Geonix	SYSTEMAIR	Gruppo Koni
<i>F. Njesi Rikuperatore Ajri- V.ajri. 1950m³/h ~ Presioni statik: 250 Pa Fel.e vetilatorve 0.75x2 kW 1F~230V, 50Hz Eficensa e rikuperimit 72% Kapaciteti i baterise Ftohje/Ngrohje 22.4/25 kW Dimensionet AxBxH: 1800×1600x460mm, 210 kg"</i>	FC20-L- HËH	SYSTEMAIR	Gruppo Koni
<i>F.Chiller-Pompe për njesinë e trajtimit të ajritVersionin pompe nxehtesie ajer/uje,kompl. me kitin Kap.ftohes/ngrohjes.:412ne temp/389 kË.Temp. të jashtë. verë/dimer:36°C/+7°C F.elek./tensio./intensi./ushqim.:160kW/400V/273.4</i>	SYSCROL L 450 AIR	SYSTEMAIR	Gruppo Koni

<i>A/3F~50Hz. struk.metalike mbeshtet.me amortizator.AxBxH= 3.97x2.2x2.45m.</i>			
<i>F.POMPA E IMPIANTIT TE MBROJTJES NGA ZJARRIT K.Teknike:Grupi i pompave MNZ sipas EN 12845,i perbere nga:-Pompe elektrike (master) Q= 45m³/h, H=65mkH/20, 22kW - Pompe dizel(stand by)Q=45 m³/h,H=65mkH22 kW - Pompe pilot (Jockey) Q = 5 m³/h, H = 52 mkH/20 , 0.75 kW Grupi i MNZ i kompletuar</i>	Hydeo EN 40-250/238	Grundfos	Grundfos
<i>F."Pomp.Qark.in-line binjake me 1 shkalle me motor Inverter sipas IEC60034-30-2,me sens.pres. diferencial, panel kontr.dhe komand., te lidhet me sist. BMS me ane te moduleve te komun. dhe me ekran -Pru.:4 m³/h- Preval.:10 mkH2O-Fuqia e inst.: 0.3 kW,- Intens.rrymës:1.32A,-Tensi.:1F~ 2230V50Hz-Lidh.</i>	MAGNA 3 D 32-120 F	Grundfos	Grundfos
<i>F.Pomp nxehe per prodh.e ujit te ngrohje sanitar(Vers. ajer/uje, komplet me kitin h.. Kap.ngrohjes ne temp.7°C:88kË-15236 l/h.Fuq. elek./tens./intens ./ushq.:30 kË/400V/3 F~ 50Hz . Temperatura e ujit dergim/kthim 65°C/60°C Kit hidraulik (akumul, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi, valvol, etj..). Gr</i>	POLARIX8 0	SYSTEMAIR	Gruppo Koni
<i>F.Pompa per furnizimin me uje sanitar (HS) - Prurja: 18 m³/h, - Prevalenca: 65 mkH2O, - Fuqia elektrike: 3x5.5 kË, rryma 2x10.1 A, - Ushqimi: 3F/400V/50Hz, - Lidhjet: DN 65, PN /16 E kompletuar me panel dhe me te gjithë aksesoret e nevojshem.</i>	HYDRO MULTI E 3	Grundfos	Grundfos
<i>Furnizim Paisje energjie UPS/3F-20kVA, pavaresi 15min</i>	E3SUPS20	Schneider	ITE
<i>Central Zjarri i Adresueshem i kompozuar, i kompletuar me dy Loop, i certifikuar EN 54-2, EN 54-4. Mundesi zgjerimi deri ne 8 loop. Mundesi per te ndare ne 2000 zona. Te ruaj deri ne 10000 ngjarje. Set kablllo modul kontrolli-bateri. Set kablllo modul kontrolli-UPS. Kavallote lidhje skedash 2 vende</i>	CAD 150-80	Detnov	IMPACT
<i>Furnizim NVR 32CH,PoE,4K,HDD 4x4TB SEAGATE,full HD</i>	DS-7732	Hikvision	IMPACT

Autorizimet dhe kataloget e pajisjeve janë paraqitur të njohura me origjinalin në gjuhën shqipe dhe atë angleze por nuk janë të shoqëruara me vërtetim përkthimi nga një përkthyes zyrtar Anglisht-Shqip, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar i cili në nenin 135 parashikon:

Neni 135

Vërtetimi i përkthimeve

Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të

përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.

Në kuptim të dispozitës së mësipërme, dokumentacioni i paraqitur duhet të ishte i përkthyer nga përkthyes zyrtarë të administruar nga Ministria e Drejtësisë ose nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga Ministria e Drejtësisë.

Nga verifikimi në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë (<https://www.drejtesia.gov.al/perkthyesit/>), rezulton se notere “Sh. Gj” nuk është në listën e përkthyesëve zyrtarë të gjuhës Angleze.

Në konkluzion dokumentacioni i paraqitur nga BOE nuk konsiderohet i vlefshëm duke mos përmbushur kërkesat për kualifikim të publikuara në DST:

- pika 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: *Shqip X*
- “Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, B. Përgatitja e ofertave, 2. Gjuha e Ofertës: Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. **Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë dokumentet e paraqitura në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në gjuhën shqipe.**”

- Pika 2.3.8/b, ku citon se: “Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara”.

Ne këtë kuptim operatori ka dështuar të përmbushë kriterin e kualifikimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe kualifikuese.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

8. “LEON KONSTRUKSION” shpk

K71820009I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Për arsyet e mëposhtme:

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.8/a, të “Kapacitetit Teknik” ku kerkohet për pajisjet e tabelës se dhëne në piken 2.3.8, operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertoje këto pajisje. Në rast paraqitje autorizim distributori i autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

Nga verifikimi I dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se ofertuesi ka deklaruar se do furnizojë pajisjet me: model, prodhuar nga/dhe distributor, si më poshtë:

Nr.	Lloji I pajisjes	MODEL	KOMPANIA PRODHUESE	DISTRIBUTOR
1	<i>F. NJESI TRAJTIMI AJRI - (me bateri me AHU KIT)V.ajri max. 4000m³/h ~ Renia e presionit te jashtem dergim/kthim 600/250 Pa Fel.e vetilator. 2x0.75 kË 1F~230V,50Hz Kap.termik ne ngrohje /ftohje:40.0 kË/65 kË Bateria pas ngrohese elek .me fuqi 20 kW.F. elektrike e vent/drg 11kW 3F+N/400V/50Hz/kthim 4kW</i>	AHU – 4000 m3/h	G&R shpk	Superior Group
2	<i>F.Gjenerator avulli per U.T.A. - Karakteristikat Teknike : - Sasia e avullit te prodhuar :9-90 kg/h - Presioni min/max i punes : 1 -10 bar - Fuqia elektrike 2x34.2 kW,(400V - 3F~ 50Hz)- Dimensionet: AxBXC = 675 x 730 385 mm I kompletuar me panel elektrik dhe te gjithë aksesoret e nevojshem per funks</i>	K60-380	Elsteam srl	Superior Group
3	<i>F. Njesi Rikuperatore Ajri- V.ajri. 1950m³/h ~ Presioni statik: 250 Pa Fel.e vetilatorve 0.75x2 kW 1F~230V,50Hz Eficensa e rikuperimit 72% Kapaciteti i baterise Ftohje/Ngrohje 22.4/25 kW Dimensionet AxBxH: 1800×1600x460mm, 210 kg"</i>	1950 m3/h	G&R shpk	Superior Group
4	<i>F.Chiller-Pompe per njesine e trajtimit te ajritVersionin pompe nxehtesie ajer/uje,kompl. me kitin Kap.ftohes/ngrohes .:412ne temp/389 kË.Temp. te jasht. vere/dimer:36°C/+7°C F.elek./tensio./intensi./ushqim.:160kW/400V/273.4 A/3F~50Hz. struk.metalike mbeshtet.me amortizator.AxBxH= 3.97x2.2x2.45m.</i>	CLSFE35HË/ ZR1A CLSFE75HË/ ZR1A CLSFE155HË/ ZR1A	Cooper & Hunter	Superior Group
5	<i>F.Pomp nxehe per prodh.e ujit te ngrohje sanitar (Vers. ajer/uje, komplet me kitin h.. Kap.ngrohes ne temp.7°C:88kË-15236 l/h.Fuq. elek./tens./intens./ ushq .:30 kË/400V/3 F~~ 50Hz . Temperatura e ujit dergim/kthim 65°C/60°C Kit hidraulik (akumul, ene zgjerimi, pompe riqarkullimi, valvol, etj..). Gr</i>	CLSFE75HË/ ZR1A	Cooper & Hunter	Superior Group

Nga verifikimit i dokumentacionit rezulton se ofertuesi ka paraqitur autorizim nga distributori “Superior Group” shpk per furnizimin me pajisjet sa më sipër por operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose dokumentin e angazhimit midis prodhuesve dhe distributorit tw autorizuar “Superior Group” shpk.

Autorizimi i prodhuesit është një mjet i rëndësishëm për të garantuar origjinën dhe cilësinë e produktit, përgjegjësinë ligjore, garancinë teknike pasi vetëm distributorët e autorizuar kanë të drejtën ligjore të ofrojnë mbështetje teknike, mirëmbajtje, pjesë këmbimi dhe garanci zyrtare nga prodhuesi. Në mungesë të tij, autoriteti kontraktor rrezikon të marrë produkte jo origjinale, pa garanci dhe me vështirësi në mirëmbajtjen e tyre.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.8/b, të “Kapacitetit Teknik” të kriterëve të vecanta ku është kërkuar: “Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit të autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha paisjet sipas pikës 2.3.8. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Nga verifikimi i katalogut të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik për pajisjen: *“Central Zjarri i Adresueshem i kompozuar, i kompletuar me dy Loop, i certifikuar EN 54-2, EN 54-4. Mundësi zgjerimi deri në 8 loop. Mundësi për të ndarë në 2000 zona. Të ruaj deri në 10000 ngjarje. Set kablllo modul kontrolli-bateri. Set kablllo modul kontrolli-UPS. Kavallote lidhje skedash 2 vende”* konstatohet mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga DST dhe atyre të ofruara nga ofertuesi.

Konkretisht, ofertuesi ka dorëzuar në SPE të dhënat mbi modelin dhe kompaninë prodhuese për pajisjen “Central Zjarri” model “DHI-HY-1025” të prodhuar nga shoqëria “DAHUA TECHNOLOGY”. Nga verifikimi i katalogut të pajisjes rezulton se specifikimet teknike të tij nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST pasi pajisja e ofertuar nga operatori ekonomik është e kompozuar në 2 Loop dhe nuk ka mundësi zgjerimi deri në 8 loop. Paneli mbështet deri në 508 pajisje adresuese, por nuk specifikohet ndarja në 2000 zona si dhe nuk ka kapacitet ruajtjeje deri në 10 000 ngjarje (*Specifikimi thotë “ultra-long history record”, por nuk e specifikon sasinë*).

Specifikimet teknike janë thelbësore në një procedurë prokurimi sepse ato përcaktojnë qartë karakteristikat, cilësinë dhe standardet e produktit, duke siguruar që ofruesi i plotëson nevojat e Autoritetit Kontraktor si dhe ato shërbejnë si bazë për vlerësimin e ofertave dhe verifikimin e përputhshmërisë së mallrave me kërkesat e parashikuara në DST.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e cilesisë së kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

KVO gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përkatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

➤ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.3 të “Kapacitetit teknik” ku kerkohet: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:*

- Kontratë pune e vlefshme;
- Diplomë.

***Shënim:** Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

